




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

V L O R Ë



NR.876 AKTI
DT.ARDHJES 06.10.2015

NR.659 VENDIMI
DT.VENDIMIT 03.12.2015

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTAR: LAURENT FUÇIA

Me pjesmarrjen e sekretares gjyqësore Miranda Sinanaj, sot në Vlorë, më datë 03.12.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me Nr.876 Akti, me palë:

KËRKUESE:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga Prokurori Klodian Braho.

I PANDEHUR:

Timotheo Dhimolea, i biri i Petro dhe Fotina, i datëlindjes 24.08.1953, lindur dhe banues në Vlorë, Lagjia "Isa Boletini", pallat Nr.1283, me arsim të lartë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me gjendje civile i martuar, i padënuar më parë, i hetuar dhe gjykuar në mungesë të një masë sigurimi, i mbrojtur nga avokati i zgjedhur me deklaram, Av.Syrja Zeneli.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Gjykata, pasi administroi aktet e ndodhura në dosjen gjyqësore, e shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoi diskutimet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuan:

-Pala akuzuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga Prokurori Klodian Braho kërkoi: "Deklarimin fajtor të pandehurit Timotheo Dhimolea për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2(dy) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të urdhërohet zbritja e 1/3 së dënimit të dhënë ndaj të pandehurit.

Në aplikim të nenit 391/1 të K.Pr.Penale, dokumentat e sekuestruara:
1.Vendimi Nr.425, datë 30.12.2008 i Z.R.K.K.P-Vlorë, si dhe planvendosja e pronës bashkangjitur ketij vendimi.

2.Vërtetimi Nr.2377 Prot., datë 30.12.2009 i Z.R.K.K.P-Vlorë.

3.Vendimi Nr.425, datë 30.12.2009 i Z.R.K.K.P-Vlorë.

4.Shkresa Nr.5111/1 Prot., datë 15.03.2012 e Z.R.K.K.P-Vlorë, të deklarohen të falsifikuara, duke u urdhëruar asgjësimi i tyre.

Në aplikim të nenit 36/b të Kodit Penal, produkti i veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, i ndodhur nën efektin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, pasuria e paluajtshme me sipërfaqe totale 128.000 m², e ndarë në pasuritë e mëposhtme:

1.Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.230, datë 20.06.2012, ZK 2863, me sipërfaqe 70.000 m², me nr.1, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".

2.Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.230, datë 20.06.2012, ZK 2863, me sipërfaqe 1.000 m², me nr.3, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".

3.Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.230, datë 20.06.2012, ZK 2863, me sipërfaqe 3.000 m², me nr.5, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".

4.Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.230, datë 20.06.2012, ZK 2863, me sipërfaqe 22.000 m², me nr.6, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".

5.Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.24, datë 29.01.2013, ZK 2863, me sipërfaqe 27.000 m², ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".

6.Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.73, datë 13.03.2013, ZK 2863, me sipërfaqe 3.000 m², ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të shtetasit Rustem Dishaj.

7.Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.74, datë 13.03.2013, ZK 2863, me sipërfaqe 2.000 m², ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të shtetasit Kledjon Ramaj, të konfiskohet dhe të kalojë në favor të shtetit.

Shpenzimet procedurale në ngarkim të pandehurit."

-Mbrojtësi i të pandehurit Timotheo Dhimolea, Av.Syrja Zeneli kerkoi:

"Deklarimin fajtor të pandehurit Timotheo Dhimolea për veprën penale të "Falsifikimit të dokumentave", parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me minimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga dispozita, duke urdhëruar gjykata pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurit dhe vënien e tij në provë për një periudhë kohore e cila do të vlerësohet nga gjykata."

-I pandehuri Timotheo Dhimolea: "Jam dakord me avokatin".

VËREN:

A.Rrethanat e faktit.

Pala kërkuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka paraqitur përpara kësaj Gjykate kërkesën me objekt "Gjykimin e procedimit penal Nr.1975 të vitit 2015, në ngarkim të pandehurit Timotheo Dhimolea, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal."

Përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, nga ana e mbrojtësit të zgjedhur me deklaram nga ana e të pandehurit Timotheo Dhimolea, Av.Syrja Zeneli, në bazë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, iu parashtrua gjykatës kërkesa për të proceduar me gjykim të shkurtuar, duke menduar se çështja mund të zgjidhej në gjendjen në të cilën ndodheshin e aktet e procedimit penal Nr.1975 të vitit 2015.

Gjykata, pasi mori pëlqimin e të pandehurit, e deklaroi të hapur diskutimin dhe ftoi prokurorin z.Klodian Braho për të shfaqur mendimin e tij mbi kërkesën, i cili u shpreh se ishte dakort me kërkesën e mbrojtësit të pandehurit Timoteho Dhimolea për gjykim të shkurtuar dhe pas shqyrtimit tërësor të të gjitha akteve të ndodhura në fashikullin e gjykimit, ku konstatoi se ato nuk përmbanin ndonjë pavlefshmëri nga ato të parashikuara në nenin 128 të K.Pr.Penale, vlerësoi se bazuar në nenin 404 të Kodit të Procedurës Penale, kishte vend për të proceduar me gjykim të shkurtuar, pasi çmoi se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet pa cënuar drejtësinë dhe interesat e ligjshëm të pandehurit.¹

Gjykata, në marrjen e vendimit për lejimin procedimin me ritin e gjykimit të shkurtuar ndaj të pandehurit Timotheo Dhimolea mban në konsideratë edhe standartin kushtetues vendosur nga Gjykata Kushtetuese në Vendimin Nr.4, datë 10.02.2012, ku konkretisht theksohet se: "Nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, edhe në rastin kur procedohet me gjykim të shkurtuar, njësoj si në gjykimin e zakonshëm, do të mund të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe të dënojnë të pandehurin për një vepër penale të ndryshme dhe me një masë dënimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, instituti do të humbiste çfarëdolloj justifikimi kushtetues, për arsye se i pandehuri, duke hequr dore në mënyrë të vullnetshme nga disa parime kushtetuese si parimi i barazisë së armëve dhe nga parimi i kontradiktoritetit, do të sakrifikoje të drejtat e tij kushtetuese jo vetëm pa pasur asnjë lloj përfitimi, por edhe duke marrë një dënim më të lartë nga ai që priste."

Referuar akteve procedurale të fazës së hetimeve paraprake, mbi bazën e të cilave dokumentohet veprimtaria hetimore e organit procedues, në kuadër të procedimit penal nr.1975, të vitit 2015, në ngarkim të pandehurit Timotheo Dhimolea, të cilat, pas aplikimit të ritit të posaçëm të gjykimit të shkurtuar kthehen në fashikull gjyqësor dhe marrin vlerën e provave për gjykatë, ka rezultuar e provuar se: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e kallëzimit penal të

¹ Vendimi unifikues penal Nr.2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

paraqitur nga ana e AKKP-Tiranë, në lidhje me disa vendime të ish-ZRKKP-Vlorë, si dhe me veprimet përkatëse të kryera nga ana e personave të interesuar pranë ish-ZRKKP-ve dhe Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ka vendosur fillimisht regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të "Falsifikimit të dokumentave", parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, duke shënuar më pas, në kolonën përkatëse të regjistrit të njoftimit të veprave penale, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale, shtetasit Timotheo Dhimolea.

Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera në kaudër të këtij procedimi penal, ka rezultuar se, në regjistrat e pasurive të paluajtshme të ZVRPP-Vlorë është regjistruar në emër të trashëgimtarëve të të ndjerit Petro Dhimolea, pasuria e paluajtshme e llojit pyll, me sipërfaqe 12.8 ha ose 128.000 m², me numrin rendor nr.186, datë 06.06.2012, e ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, për të cilën, është proceduar me lëshimin e certifikatës së pronësisë.

Ka rezultuar se, pasuria e sipërcituar është regjistruar mbi bazën e aplikimit të datës 01.03.2012 të bërë nga ana e të pandehurit Timotheo Dhimolea, njëri prej trashëgimtarëve të të ndjerit Petro Dhimolea, i cili për regjistrimin e kësaj pasurie ka përdorur si titull pronësie, vendimin Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë, e shoqëruar me planvendosjen përkatëse, në dispozitivin e të cilit nuk përmendet emri i subjektit në favor të të cilit është realizuar njohja dhe kthimi i sipërfaqës prej 12.8 ha tokë pyjore, por në pjesën arsyetuese të tij, është përmendur se subjekti përfitues ka qënë Petro Dhimolea.


Ka rezultuar se, nga ana e të pandehurit Timotheo Dhimolea, në kërkesën e paraqitur pranë ZVRPP-Vlorë për regjistrimin e vendimit Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë, është paraqitur gjithashtu edhe shkresa Nr.5111/1 Prot., datë 15.03.2012 e AKKP-Tiranë, vendimi Nr.1796, datë 26.12.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është vendosur lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për vendimin Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë, si dhe një kopje e vendimit Nr.425, datë 30.12.2009 të ZRKKP-Vlorë, i cili ka rezultuar i njëjtë me vendimin e vitit 2008, me ndryshimin e vetëm, i cili konsistonte në vitin e vendimit.

Nga kqyrja e realizuar në regjistrat e ZVRPP-Vlorë, ka rezultuar se, në datën 20.06.2012, si rezultat i kërkesës së paraqitur për ndarjen e pasurisë prej 12.8 ha tokë pyjore, është realizuar ndarja e kësaj pasurie në 6(gjashtë) pasuri të tjera dhe konkretisht, pasuria me nr.1, me sipërfaqe 70.000 m², pasuria nr.2, me sipërfaqe 30.000 m², pasuria nr.3, me sipërfaqe 1000 m², pasuria nr.4, me sipërfaqe 2000 m², pasuria nr.4, me sipërfaqe 2000 m², pasuria nr.5, me sipërfaqe 3000 m² dhe pasuria nr.6, me sipërfaqe 22.000 m².

Në vijimi, ka rezultuar se, pasuria me nr.2, me sipërfaqe 30.000 m², është ndarë në dy pasuri të tjera, në pasurinë me nr.23, me sipërfaqe 3000 m² dhe në pasurinë nr.24, me sipërfaqe 27.000 m².

Nga kqyrja e dokumentave të sekuestruara pranë ZVRPP-Vlorë, ka rezultuar se, pasuria me nr.23, me sipërfaqe 3000 m², ka kaluar në pronësi të shtetasit Rustem Dishaj, nga ana e shtetasit Mariglen Cuni (si përfaqësues me prokurën e përgjithshme Nr.160 Rep., Nr.73 Kol., datë 01.03.2013 i trashëgimtarëve "Dhimolea") përmes kontratës noteriale të shitjes Nr.282 Rep., Nr.110 Kol., datë 08.03.2013, e cila është regjistruar më pas në ZVRPP-Vlorë, me numrin rendor nr.73, datë 13.03.2013.

Ka rezultuar se, pasuria me nr.4, datë 20.06.2012, me sipërfaqe 2000 m², ka kaluar në pronësi të shtetasit Kledjon Ramaj, nga ana e shtetasit Mariglen



Cuni (si përfaqësues me prokurorin e përgjithshme Nr.160 Rep., Nr.73 Kol., datë 01.03.2013 i trashëgimtarëve "Dhimolea") përmes kontratës noteriale të shitjes Nr.281 Rep., Nr.109 Kol., datë 07.03.2013, e cila është regjistruar më pas në ZVRPP-Vlorë, me numrin rendor nr.74, datë 13.03.2013.

Nga administrimi i shkresave "Kthim përgjigje", të ardhura nga ana e AKKP-Tiranë, ka rezultuar se, në datën 28.09.2010, nga ana e shtetasit Arben Ismailaj, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të pandehurit Timotheo Dhimolea, sipas prokurës së përgjithshme Nr.1483 Rep., Nr.1305 Kol., datë 22.09.2010, është paraqitur pranë AKKP-Tiranë kërkesa për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin në natyrë të pasurisë së paluajtshme në emër të subjektit të shpronësuar Petro Dhimolea.

Nga akti i ekspertimit tekniko-grafik Nr.8295, datë 24.08.2015, ka rezultuar se, vendimi Nr.425, datë 30.12.2008 i ZRKKP-Vlorë, planvendosja e pronës bashkangjitur këtij vendimi, shkresa Nr.5111/1 Prot., datë 15.03.2012 e lëshuar nga AKKP-Tiranë, si dhe dokumenti vërtetim Nr.2377, datë 30.12.2009 i ZRKKP-Vlorë, janë të falsifikuara.

Nga akti i ekspertimit tekniko-grafik Nr.5781, datë 11.06.2015, ka rezultuar se, dokumenti prokurorë e përgjithshme Nr.160 Rep., Nr.73 Kol., datë 01.03.2013, si dhe kontratat noteriale të shitjes Nr.282 Rep., Nr.110 Kol., datë 08.03.2013 dhe Nr.281 Rep., Nr.109 Kol., datë 07.03.2013, janë të falsifikuara.

Në kuadër të këtij procedimi penal, pas kërkesës së paraqitur nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin Nr.418, datë 11.09.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur sekuestro preventive, në lidhje me pasurinë e paluajtshme të llojit tokë pyjore, me sipërfaqe 12.8 ha ose 128.000 m², me numrin rendor nr.186, datë 06.06.2012, e ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.

Për sa më sipër, me vendimin e prokurorit "Për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës", është marrë në cilësinë e të pandehurit, shtetasi Timotheo Dhimolea, për veprën penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Pas njohjes së të pandehurit me aktet e procedimit penal nr.1975 të vitit 2015, është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq dhe për këtë qëllim, është paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (Dhoma Penale) kërkesa për gjykimin e procedimit penal Nr.1975 të vitit 2015, në ngarkim të pandehurit Timotheo Dhimolea, për veprën penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

B.Ligji i aplikueshëm.

Neni 12 i Kodit Penal parashikon se: "Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën këtëmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç".

Neni 13 i Kodit Penal, parashikon se: "Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore".

Neni 14 i Kodit Penal, parashikon se: "Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi".

Neni 47 i Kodit Penal, parashikon se: "Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese".

Neni 149 i Kodit të Procedurës Penale, në të cilin specifikohet se: "Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij".

Neni 150 i K.Pr.Penale, parashikon se: "Janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale".

Neni 152 i K.Pr.Penale, parashikon se: "Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo prove i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. 2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën."

C.Vlerësimi i gjykatës.

Neni 186 i Kodit Penal, parashikon se: "1.Falsifikimi ose përdorimi i dokumentave të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. 2.Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet."

Objekti juridik i veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligjvënësi, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së ligjshme të organeve të administratës publike apo personave juridikë privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumentave, nga veprimet e kundraligjshme, shoqërisht të rrezikshme, të kryera me faj dhe të dënueshme penalisht, që synojnë të prekin, cënojnë apo trondisin ligjshmërinë e funksionimit të këtyre organeve.

Objekti material, përfaqëson vetë dokumentat e falsifikuara, të cilat mund të jenë të ndryshme, me përjashtim të atyre dokumentave (p.sh dokumentat shkollore apo shëndetësore) të cilat, ligjvënësi për shkak të rëndësisë që paraqesin, falsifikimin apo përdorimin e tyre e ka ngritur në nivelin e veprës penale, për pasojë nëse do të gjendeshim përpara një rasti të tillë, cilësimi juridik i faktit penal do të bëhej konform dispozitës penale konkrete (p.sh. neni 187 apo 188 të Kodit Penal).

Nga ana objektive, vepra penale e "Falsifikimit të dokumentave", do të quhet e konsumuar, nëse realizohet përmes njëres apo dy formave të mëposhtme:

- i.Falsifikimit të dokumentave.
- ii.Përdorimit të tyre.

Në vendimin Nr.113, datë 27.03.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyeton se: "Format e kryerjes se veprës penale të falsifikimit të

dokumenteve janë i) hartimi ose ndërhyrja në dokument dhe ii) përdorimi. Në formën e parë të kryerjes është e domosdoshme zbulimi i autorësisë së falsifikimit.”

Gjykata çmon se, vepra penale e falsifikimit të dokumenteve, futet në kategorinë e veprave penale formale, që do të thotë se ajo do të quhet e konsumuar dhe për pasojë autori i saj do të përgjigjet penalisht, atëherë kur realizohet në njërin nga format e përmendura më sipër, pa patur nevojë për ardhjen apo mundësinë e ardhjes së ndonjë pasoje.

Midis veprimeve të autorit të veprës penale dhe falsifikimit të dokumenteve apo përdorimit të tyre, duhet të ekzistojë lidhja shkakësore në kuptimin që, dokumenti i falsifikuar apo përdorimi i tij vjen ekskluzivisht dhe vetëm si rezultat i veprimeve të autorit (*nullum crimen, nulla poena sine causa*).

Subjekti, i cili përfaqëson autorin e veprës penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, që të mbajë përgjegjësi penale dhe të jetë subjekt i procedimit dhe gjykimit penal, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore:

1. Kriterin e moshës, pra të ketë mbushur moshën 14 vjeç (ndodhemi përpara një krimi) dhe

2. Kriterin e përgjegjshmërisë, pra të jetë i aftë të kontrollojë veprimet e tij si dhe të kuptojë rëndësinë e kryerjes së tyre.

Mungesa qoftë e njërit prej këtyre dy kritereve, përbën shkak procedural që ndaj subjektit (autorit të veprës penale) të mos fillojë procedimi penal dhe nëse ka filluar ai duhet pushuar, duke proceduar me caktimin e masave mjekësore (në rastin e papërgjegjshmërisë) dhe me caktimin e masave edukuese (në rastin e moshës).

Nga ana subjektive, vepra penale e “Falsifikimit të dokumentave” kryhet vetëm me dashje direkte, në kuptimin që, autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron falsifikimin apo përdorimin e dokumentit të falsifikuar, pra ka dijeni rreth falsitetit të dokumentit që vë në përdorim.²

Qëllimi nuk është element cilësues i dispozitës penale konkrete (neni 186/1), por nisur nga fakti se, nëse ekzistenca apo mungesa e qëllimit ndikon në vetë ekzistencën e figures së veprës penale, e për pasojë edhe në përgjegjësinë penale të autorit të saj, gjykata e çmon me rëndësi t’i referohet jurisprudencës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Me Vendimin Nr. 14, datë 04.02.2009, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet se: “Vepra penale e falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, kryhet gjithmonë me dashje direkte të autorit, por krahas kësaj është e domosdoshme që të provohet se falsifikimi është bërë me qëllim fitimi ose çdo interesi tjetër personal, element ky që gjykatat nuk e kanë pasur parasysht në marrjen e vendimeve.”

Në kuadrin e interpretimit historik, gjykata i referohet me analogji edhe Udhëzimit Nr. 18, datë 07.07.1960 të Pleniumit të Gjykatës së Lartë (i cili bën fjalë për veprën penale të falsifikimit të monedhave), sipas së cilit, qëllimi i përfitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal, në veprën penale të falsifikimit të monedhave, duhet të ekzistojë gjithmonë, në të kundërt nuk do kemi këtë figurë krim.

Ligjvënësi, në kuadër të ashpërsimit të politikës penale ndaj figures së veprës penale të parashikuar në nenin 186 të Kodit Penal, ka parashikuar në të njëjtën dispozitë penale, si rrethanë cilësuese (që do të thotë se kjo figurë vepre

² Vendimi Nr. 113, datë 27.03.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Vendimi Nr. 186, datë 05.06.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

penale, e kryer në një rreth nga rrethanat cilësuese, mund të qëndronte eventualisht e parashikuar në një dispozitë të veçantë penale) rastin kur, vepra penale "mëmë", ajo e "Falsifikimit", kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një here, ose kur ka sjellë pasoja të rënda.

Në lidhje me rrethanën cilësuese të "përsëritjes", pra të kryerjes së veprës penale më shumë se një herë, gjykata vlerëson se, për t'u ndodhur përpara kësaj situatë është e nevojshme që, veprimet kriminale të autorit të veprës penale të jenë të tilla që, nga ana objektive, secili veprim kriminal në drejtim të falsifikimit apo përdorimit të dokumentit të falsifikuar, duhet të qëndrojë i mëvetësishëm apo autonom nga tjetri dhe në distanca kohore të tilla, nga i cili nxirret përfundimi se, autori i veprës penale ka cënuar dy raporte juridike të mbrojtura nga ligji, përmes dy apo më shumë veprimeve të kundraligjshme dhe të kryera me faj prej tij.

Pala kërkuese, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkoj deklarimin fajtor të pandehurit Timotheo Dhimolea, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Provat mbi bazën e së cilave, organi i akuzës e mbeshtet kërkimin e tij, janë në tërësi aktet e fashikullit të procedimit penal nr.1975 të vitit 2015, e konkretisht:

-*"Procesverbalet për sekuestrimin e dokumentave"* datë 27.05.2015, datë 28.05.2015, si dhe dokumentacioni bashkangjitur tyre.

-*Shkresa Nr.16955 Prot., datë 17.10.2014, lëshuar nga AKKP-Tiranë.*

-*Shkresa Nr.744 Prot., datë 25.05.2015, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

-*Shkresat Nr.314/1 Prot., datë 17.02.2015 dhe Nr.318/1 Prot., datë 12.02.2015, lëshuar nga AKKP-Tiranë.*

-*Shkresa Nr.3569/1 prot., datë 30.10.2015, lëshuar nga AKKP-Tiranë, si dhe dokumentacioni bashkangjitur.*

-*Aktet e ekspertimit Nr.5781, datë 11.06.2015, Nr.8295, datë 24.08.2015, Nr.1862, datë 03.03.2015, Nr.3632, datë 21.04.2015 të Drejtorisë së Policisë Shkencore Tiranë.*

-*"Procesverbalet për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave"* datë 31.10.2014, datë 27.05.2015, datë 21.05.2015, datë 16.09.2014, si dhe dokumentacioni bashkangjitur tyre.

-*"Procesverbal për pyetjen e personit nën hetim"* shtetasit Timotheo Dhimolea.

-*"Procesverbal për pyetjen e të pandehurit"* Timotheo Dhimolea.

Mbrojtësi i të pandehurit Timotheo Dhimolea, Av.Syrja Zeneli kerkoi deklarimin fajtor të pandehurit Timotheo Dhimolea për veprën penale të "Falsifikimit të dokumentave", parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me minimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga dispozita, duke urdhëruar gjykata pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurit dhe vënien e tij në provë për një periudhë kohore e cila do të vlerësohet nga gjykata.

Gjykata vlerëson se, procesi i çmuarjes së provave është proces i ndërlikuar dhe kompleks, pasi përbërës të tij janë komponentë sa juridiko-faktikë, aq edhe të brendshëm, psikologjikë, nga të cilët duhet të udhëhiqet dhe nga i cili ndikohet gjykata në formimin e bindjes së brendshme, pas shqyrtimit prej saj, në tërësi, të provave të administruara gjatë gjykimit, prova këto që duhet të jenë marrë në zbatim të kërkesave të nenit 151 të K.Pr.Penale.

Në analizën e provave, gjykata duhet të niset nga parimet bazë për vlerësimin objektiv të tyre dhe kërkesat e nenit 152 të K.Pr.Penale, sipas të cilit përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, nuk ka vlerë të paracaktoar dhe se ekzistenca e një fakti mund të nxirret edhe nga indicjet, kur ato janë të rëndësishme dhe në përputhje me njëra tjetrën.³

Nga administrimi i procesverbaleve për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave, si dhe administrimit të informacionit të ardhur në rrugë zyrtare nga ana e ZVRPP-Vlorë, rezultoi e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se, në regjistrat e pasurive të paluajtshme të ZVRPP-Vlorë është regjistruar në emër të trashëgimtarëve të të ndjerit Petro Dhimolea, pasuria e paluajtshme e llojit pyll, me sipërfaqe 12.8 ha ose 128.000 m², me numrin rendor nr.186, datë 06.06.2012, e ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, për të cilën, është proceduar me lëshimin e çertifikatës së pronësisë.

Nga sa sipër, ka rezultuar e provuar se, pasuria e sipërcituar është regjistruar mbi bazën e aplikimit të datës 01.03.2012 të bërë nga ana e të pandehurit Timotheo Dhimolea, njëri prej trashëgimtarëve të të ndjerit Petro Dhimolea, i cili për regjistrimin e kësaj pasurie ka përdorur si titull pronësie, vendimin Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë, i shoqëruar me planvendosjen përkatëse, si dhe shkresa Nr.5111/1 Prot., datë 15.03.2012 e AKKP-Tiranë, vendimi Nr.1796, datë 26.12.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është vendosur lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për vendimin Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë, si dhe një kopje e vendimit Nr.425, datë 30.12.2009 të ZRKKP-Vlorë.

Nga administrimi i shkresës Nr.744 Prot., datë 25.05.2015, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe nga kqyrja e dokumentacionit bashkangjitur saj, ka rezultuar e provuar se, nga ana e të pandehurit Timotheo Dhimolea, në gjykimin e zhvilluar përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është përdorur dokumenti vendimi Nr.425, datë 30.12.2008 i ZRKKP-Vlorë, i shoqëruar me planvendosjen përkatëse, me qëllim lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në lidhje me vendimin Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë.

Ka rezultuar e provuar se, me vendimin Nr.1796, datë 26.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për vendimin Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë.

Nga administrimi i aktit të ekspertimit tekniko-grafik Nr.8295, datë 24.08.2015, ka rezultuar e provuar se, vendimi Nr.425, datë 30.12.2008 i ZRKKP-Vlorë, planvendosja e pronës bashkangjitur këtij vendimi, shkresa Nr.5111/1 Prot., datë 15.03.2012 e lëshuar nga AKKP-Tiranë, si dhe dokumenti vërtetim Nr.2377, datë 30.12.2009 i ZRKKP-Vlorë, janë tërësisht të falsifikuara.

Nga administrimi i shkresave "Kthim përgjigje", të ardhura nga ana e AKKP-Tiranë, ka rezultuar e provuar se, në datën 28.09.2010, nga ana e shtetasit Arben Ismailaj, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të pandehurit Timotheo

³ Vendimi Nr. 31, datë 31.01.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku thuhet se "Gjykata vlerëson se dallimi midis provës dhe indicjes qëndron në atë që: nëse e para vërteton në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën ose jo të një fakti, e dyta është një rrethanë nga e cila mund të arrihet në një deduksion të logjikshëm, një konkluzion i përafërt mbi ekzistencën ose jo të një fakti."

Dhimolea, sipas prokurës së përgjithshme Nr.1483 Rep., Nr.1305 Kol., datë 22.09.2010, është paraqitur pranë AKKP-Tiranë kërkesa për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin në natyrë të pasurisë së paluajtshme në emër të subjektit të shpronësuar Petro Dhimolea.

Ka rezultuar e provuar se, në datën 20.06.2012, si rezultat i kërkesës së paraqitur për ndarjen e pasurisë prej 12.8 ha tokë pyjore, është realizuar ndarja e kësaj pasurie në 6(gjashtë) pasuri të tjera dhe konkretisht, pasuria me nr.1, me sipërfaqe 70.000 m², pasuria nr.2, me sipërfaqe 30.000 m², pasuria nr.3, me sipërfaqe 1000 m², pasuria nr.4, me sipërfaqe 2000 m², pasuria nr.4, me sipërfaqe 2000 m², pasuria nr.5, me sipërfaqe 3000 m² dhe pasuria nr.6, me sipërfaqe 22.000 m².

Në vijim, ka rezultuar e provuar se, pasuria me nr.2, me sipërfaqe 30.000 m², është ndarë në dy pasuri të tjera, në pasurinë me nr.23, me sipërfaqe 3000 m² dhe në pasurinë nr.24, me sipërfaqe 27.000 m².

Gjykata çmon se, nga shqyrtimi në tërësi i provave shkresore dhe shkencore, akteve të fashikullit të procedimit penal nr.1975 të vitit 2014(*ut supra*), të cilat duke proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar shndërrohen në fashikull gjykimi për gjykatën, në drejtim të përcaktimit të fuqisë provuese dhe vërtetësisë të secilës prej tyre, ka rezultuar e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se, i pandehuri Timotheo Dhimoleo, përmes veprimeve aktive të kundraligjshme, të cilat nga ana objektive, kanë konsistuar në përdorimin dy herë të dokumentave të falsifikuar, vendimit Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë, i shoqëruar me planvendosjen përkatëse, vendimit Nr.425, datë 30.12.2009 të ZRKKP-Vlorë, si dhe shkresës Nr.5111/1 Prot., datë 15.03.2012 të AKKP-Tiranë, një herë gjatë gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë dhe një herë gjatë aplikimit të datës 01.03.2012 të bërë pranë ZVRPP-Vlorë, me qëllim regjistrimin e këtij vendimi, duke patur dijeni në lidhje me falsitetin dhe përmbajtjen e pavërtetë të këtyre dy dokumentave, ka konsumuar të katër elementët e figurës së veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, për pasojë ai duhet të deklarohet fajtor në lidhje me këtë figurë krimi.

Gjykata vlerëson se, i pandehuri Timotheo Dhimolea, me veprime aktive të kundraligjshme, të kryera nga ana objektive, përmes përdorimit më shumë se një herë të dokumentave të falsifikuar, vendimit Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë, i shoqëruar me planvendosjen përkatëse, vendimit Nr.425, datë 30.12.2009 të ZRKKP-Vlorë, si dhe shkresës Nr.5111/1 Prot., datë 15.03.2012 të AKKP-Tiranë, të cilët përfaqësojnë edhe objektet materiale të figurës së krimit, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, ka cënuar ato raporte juridike, të cilat janë vendosur nga ligjvënësi, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së ligjshme të organeve të administratës publike në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumentave në përgjithësi, dhe në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumentave zyrtarë nga ana e AKKP-së, si organ qëndror, apo ish-ZRKKP-ve në nivel vendor, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre trajtimin e kërkesave të ish-subjekteve të shpronësuar apo trashëgimtarëve të tyre, në lidhje me njohjen e së drejtës së pronësisë, kthimit dhe kompensimit të pronave.

I pandehuri Timotheo Dhimolea, në momentin e kryerjes së veprës penale, kishte mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ka qënë i përgjegjshëm

përpara ligjit penal në lidhje me veprimet e tij shoqërisht të rrezikshme, të kundraligjshme dhe të kryera me faj.

Në drejtim të "leximit" të anës subjektive të pandehurit Timotheo Dhimolea, në lidhje me veprën penale të "Falsifikimit të dokumentave" e kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, gjykata i referohet elementëve të anës objektive të kryerjes së veprës penale, dhe konkretisht, veprimeve apo mosveprimeve të kundraligjshme të pandehurit, kohës, vendit dhe mekanizmit të kryerjes së tyre.

Nga administrimi i shkresave "Kthim përgjigje", të ardhura nga ana e AKKP-Tiranë, ka rezultuar e provuar se, në datën 28.09.2010, nga ana e shtetasit Arben Ismailaj, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të pandehurit Timotheo Dhimolea, sipas prokurës së përgjithshme Nr.1483 Rep., Nr.1305 Kol., datë 22.09.2010, është paraqitur pranë AKKP-Tiranë kërkesa për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin në natyrë të pasurisë së paluajtshme në emër të subjektit të shpronësuar Petro Dhimolea, kërkesë për të cilën, nga ana e AKKP-Tiranë nuk rezulton ende të jetë marrë ndonjë vendim.

Në këto rrethana fakti, të provuara gjatë gjykimit përmes administrimit të provave shkresore, duke u nisur edhe nga forma e fajit përmes së cilës konsumohet figura e krimit të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, gjykata krijon bindjen tej çdo dyshimi të arsyeshëm se, i pandehuri Timotheo Dhimolea, duke patur dijeni mbi mungesën e një vendimi në favor nga ana e ish-ZRKKP-Vlorë apo AKKP-Tiranë, si trashëgimtar i subjektit Petro Dhimolea, për të cilin ai ka aplikuar pranë AKKP-Tiranë në datën 28.09.2010, me dashje direkte ka përdorur më shumë se një herë vendimin Nr.425, datë 30.12.2008 të ZRKKP-Vlorë, i shoqëruar me planvendosjen përkatëse, vendimin Nr.425, datë 30.12.2009 të ZRKKP-Vlorë, si dhe shkresën Nr.5111/1 Prot., datë 15.03.2012 të AKKP-Tiranë, duke patur dijeni të rregullt në lidhje me falsitetin, pra përmbajtjen dhe pasqyrimin e pavërtetë të fakteve dhe rrethanave të pasqyruara në dokumentat e përdorur prej tij, duke synuar përfitimim e të drejtës së pronësisë mbi sipërfaqen prej 12.8 ha tokë pyjore, e ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, Vlorë, dhe regjistrimit të saj në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ZVRPP-Vlorë.

Në arritjen e këtij përfundimi, gjykata i referohet parashikimeve të neneve 149 dhe 152 të K.Pr.Penale në harmoni me nenin 186/2 të Kodit Penal, të cilat rregullojnë dhe normojnë procesin e çmuarjes së provave nga ana e gjykatës, në funksion të vërtetësisë dhe fuqisë provuese të secilës prej tyre, pa i dhënë vlerë të paracaktuar asnjërës prej tyre (*shih me lart provat e paraqitura nga ana e organit të akuzës*).

D.Individualizimi i llojit dhe masës së dënimit.

Neni 1/c i Kodit Penal përdor termin "drejtësi e caktimit të fajësisë dhe dënimit" dhe ky term zërthehet më tej në nenin 47 të Kodit paragrafi i dytë i cili parashikon elementët që merr parasysh gjykata në caktimin e dënimit, duke i shërbyer gjithmonë parimit të drejtësisë në caktimin e dënimit.

Ligjvënësi, i ka kushtuar rëndësi caktimit të dëmit penal nga gjykata, jo vetëm në aspektin e dhënies së një dënimi sa më të drejtë dhe proporcional, por edhe në aspektin e qëllimit që ka dënimi penal i përcaktuar në një vendim gjyqësor dhe që lidhet me edukimin dhe rehabilitimin e fajtorit, me parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm si dhe me ndëshkimin e tij.

Në vendimin nr. 19, datë 01.06.2011, Gjykata Kushtetuese ndër të tjera shprehet se: "Duke pasur parasysh dhe doktrinën e konsoliduar europiane në këtë fushë, konstaton se, që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjestim me veprën e kryer. ...dënimi me burgim, konsiston në privimin nga liria dhe si i tillë duhet përdorur si "extrema ratio", parimi i individualizimit përmban në thelb parimin e proporcionalitetit."

Gjykata çmon, t'i referohet në kuadrin e një precedenti orientues, Udhëzimit Nr.2, datë 14.03.1979 të Plenumit të Gjykatës së Lartë, ku përcaktohen elementët përbërës të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe konkretisht:

a)Objekti.

b)Vendi.

c)Koha.

d)Gjendja në të cilën kryhet vepra penale.

e)Nëse vepra penale është e përhapur në atë rreth.

f)Rrethanat që kanë ndikuar në kryerjen e saj.

Objekti. Ligjvënësi me anë të parashikimit nenit 186 të Kodit Penal ka marrë në mbrojtje të posaçme juridike-penale, marrëdhëniet juridike të vendosura, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së ligjshme të organeve të administratës publike apo personave juridikë privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumentave, nga veprimet e kundraligjshme, shoqërisht të rrezikshme, të kryera me faj dhe të dënueshme penalisht, që synojnë të prekin, çenojnë apo trondisin ligjshmërinë e funksionimit të këtyre organeve.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se, edhe produkti apo përfitimi i ardhur nga falsifikimi apo përdorimi i dokumentit të falsifikuar, është element, i cili ndikon në mënyrë proporcionale në rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, për pasojë edhe në caktimin e dënimit ndaj një të pandehuri konkret.

Ka rezultuar e provuar se, në çështjen penale objekt gjykimi, produkt i veprës penale të konsumuar nga ana e të pandehurit Timotheo Dhimolea, ka qënë sipërfaqja prej 12.8 ha apo 128.000m2 tokë, e ndodhur në fshatin Palasë, Bashkia Himarë, Vlorë.

Marzhin e dënimit penal. Gjithashtu, në individualizimin e llojit dhe masës së dënimit penal ndaj të pandehurit Timotheo Dhimolea, gjykata merr në konsideratë marzhin e dënimit penal të veprës penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, e cila është konsideruar si krim dhe dënohet me me burgim nga 6(gjashtë) muaj deri në 5(pesë) vjet.

Rrezikshmëria shoqërore e autorit. Për interpretimin e "rrezikshmërisë së autorit të saj" është e nevojshme të përmendim disa elementë orientues për t'u mbajtur parasysh, që Udhëzimi i mësipërm identifikon si:

a) Gjendja sociale; b) Profesionit; d) Gjendja familjare; e) Gjendja gjyqësore.

Vlen të evidentohet fakti se, edhe ky kriter në caktimin e dënimit qëndron në përpjestim të drejtë me rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe shkallës së fajësisë në realizimin e saj.

Personaliteti i të pandehurit. I pandehuri Timotheo Dhimolea nuk njihet si

person me rrezikshmëri shoqërore dhe me sjellje devijante në shoqëri. Gjatë hetimeve paraprahe si dhe gjatë gjyqimit, i pandehuri ka mbajtur qëndrimin se, ka përdorur vetëm një dokument, i cili ka qënë i falsifikuar, vendimin Nr.425, datë 30.12.2009 të ZRKKP-Vlorë, por për të cilin ai nuk ka patur dijeni mbi falsitetin tij.

Gjendja familjare. I pandehuri është i martuar dhe me tre fëmijë⁴.

Gjendja gjyqësore. Gjykata merr në konsideratë faktin se i pandehuri Timotheo Dhimolea, figuron me gjendje gjyqësore i pa dënuar më parë.

Shkalla e fajit. Sikurse u analizua më sipër, vepra penale objekt gjykimi, është kryer nga i pandehuri nëpërmjet dashjes direkte, si një nga format e fajit që parashikon ligji penal dhe me qëllim përfitimi për vete apo persona të tjerë.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në caktimin e masës së dënimit ndaj të pandehurit Timotheo Dhimolea, gjykata merr në konsideratë, ndër të tjera, rrethanat lehtësuese (nenet 48 dhe 49 të Kodit Penal), të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektive që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët të veprës penale dhe autorit të saj.

Konkretisht në çështjen objekt gjykimi, gjykata çmon se, nuk rezultoi e provuar asnjëra prej rrethanave lehtësuese dhe rënduese, të parashikuara në mënyrë eksplicite nga neni 48 dhe 50 i Kodit Penal.

Gjykata vlerëson se, referuar nenit 49 të Kodit Penal, në kuadër të evidentimit të rrethanave lehtësuese me karakter indikativ, në funksion të individualizimit të llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurit Timotheo Dhimolea, duhet marrë në konsideratë nivelin arsimor i të pandehurit, i cila figuron me arsim të lartë, gjendja e tij familjare, mosha e të pandehurit (62 vjeç), si dhe gjendja shëndetësore e tij, nga e cila rezulton se, ai vuan nga tumori shtresor gastroentrik i stomakut dhe përfiton pension invaliditeti të pjesshëm nga sëmundje të përgjithshme⁵.

Në këto kushte, bazuar në nenet 1/c, 47-50 dhe 186/2 të Kodit Penal, duke patur në konsideratë kryesore lidhjen logjike dhe strukturore të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit gjyqësor me dispozitivin e tij⁶, në funksion të respektimit të parimit të proporcionalitetit në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjykata çmon se, i pandehuri Timotheo Dhimolea duhet të dënohet me 2(dy) vjet burgim, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Gjykata çmon se, caktimi i një mase të tillë dënimi është në raport të drejtë dhe rrjedhojë logjike e vlerësimit të të gjitha konditave juridiko-penale të parashikuara nga neni 47 i Kodit Penal dhe do t'i shërbejë edukimit, rehabilitimit dhe parandalimit të posaçëm dhe të përgjithshëm të pandehurit, në lidhje me veprën penale të kryer prej saj.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 379, 390 dhe 391 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe neneve 1/c, 47 dhe 186/2 të Kodit Penal,

⁴ Certifikata e përbërjes familjare, datë 05.10.2015, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Vlorë.

⁵ Vërtetimi mjekësor Nr.39143, datë 20.12.2011, lëshuar nga Klinika Onkologjike Janinë, si dhe vërtetimi Nr.866 Prot., datë 16.06.2015, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë.

⁶ Vendimi Nr.33, datë 08.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese (faqe nr.4).

VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të pandehurit Timotheo Dhimolea për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
2. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.
3. Vuajta e dënimit me burgim për të pandehurin do të fillojë nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
4. Në aplikim të nenit 391/1 të K.Pr.Penale, dokumentat e sekuestruara:
 - (i) Vendimi Nr.425, datë 30.12.2008 i Z.R.K.K.P-Vlorë, si dhe planvendosja e pronës bashkangjitur këtij vendimi.
 - (ii) Vërtetimi Nr.2377 Prot., datë 30.12.2009 i Z.R.K.K.P-Vlorë.
 - (iii) Vendimi Nr.425, datë 30.12.2009 i Z.R.K.K.P-Vlorë.
 - (iv) Shkresa Nr.5111/1 Prot., datë 15.03.2012 e Z.R.K.K.P-Vlorë, të deklarohen të falsifikuara, duke u urdhëruar asgjesimi i tyre.
5. Në aplikim të nenit 36/b të Kodit Penal, produkti i veprës penale të "Falsifikimit të dokumentave" më shumë se një herë, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, i ndodhur nën efektin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, pasuria e paluajtshme me sipërfaqe totale 128.000 m², e ndarë në pasuritë e mëposhtme:
 - (i) Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.230, datë 20.06.2012, ZK 2863, me sipërfaqe 70.000 m², me nr.1, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".
 - (ii) Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.230, datë 20.06.2012, ZK 2863, me sipërfaqe 1.000 m², me nr.3, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".
 - (iii) Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.230, datë 20.06.2012, ZK 2863, me sipërfaqe 3.000 m², me nr.5, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".
 - (iv) Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.230, datë 20.06.2012, ZK 2863, me sipërfaqe 22.000 m², me nr.6, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".
 - (v) Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.24, datë 29.01.2013, ZK 2863, me sipërfaqe 27.000 m², ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të bashkëpronarëve "Dhimolea".

(vi).Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.73, datë 13.03.2013, ZK 2863, me sipërfaqe 3.000 m2, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të shtetasit Rustem Dishaj.


(vii).Pasuria e regjistruar në regjistrin hipotekor Nr.74, datë 13.03.2013, ZK 2863, me sipërfaqe 2.000 m2, ndodhur në vendin e quajtur "Maitka", fshati Palasë, Bashkia Himarë, e regjistruar në emër të shtetasit Kledjon Ramaj, të konfiskohet dhe të kalojë në favor të shtetit.

6. Shpenzimet procedurale i ngarkohen të pandehurit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 10 (dhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
8. **U shpall sot në Vlorë, më datë 03.12.2015.**

**SEKRETARE
MIRANDA SINANAJ**



**GJYQTAR
LAURENT FUÇIA**



Shpenzimet gjyqësore:

1.Në fazën e hetimeve paraprake=4.000 lekë.

2.Në fazën e gjyqimit=1.000 lekë.

Totali: 5.000 lekë.




Vendimi mori formë të prerë me Vendimin Nr. 560 datë 12.10.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku është vendosur :

- Lënien në fuqi të vendimit gjyqësor penal Nr. 659 datë 03.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me ndryshimin :
- Urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin për një periudhë tre vjeçare, duke u urdhëruar i pandehuri Timotheo Dhimolea të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.

KANCELARE
Rezarta TAUSHANI

Vlorë më datë 09.11.2016



The image shows a handwritten signature in black ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'GJYKATËS SË APELIT VLORË' and 'KANCELARE' at the bottom. The signature is written in a cursive style.